

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Sherbim- mirembajtje i gjeneratorit diezel te emergjences (furnizim-vendosje) ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 31127000-2

VLERA E FONDIT LIMIT:

1’960’000 (njemilion e nentëqind e gjashtedhjetë mijë leke) pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Termocentrali-Vloresh.a , ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar,

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, si dhe nenit.....

(shënim: plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare, 2021, 2022,2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar,.

- **Argumentimi i AK :** Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Kjo vlere është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme në funksion të realizimit me sukses të kontrates

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Nenin 43 **Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare** të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare _____, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të(shëno bazën ligjore), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, _____(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e fondit limit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, në të cilën shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara

ose

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve të mësipërme të kontratave të ngjashme të realizuara, e bën ofertën të vlefshme

2.3.2 Operatori/operatorët ekonomik pjesëmarrës në gare, të paraqesin në sistemin elektronik të prokurimit SPE skedat teknike ose kataloget për çdo artikull të kërkuar në specifikimet teknike, objekt prokurimi.

2.3.3 Operatori/operatorët ekonomik pjesëmarrës në gare, duhet të disponojnë programet si më poshtë:

- program për programimin dhe testimin e modulit të kërkuar sipas specifikimeve teknike të pasqyruara në shtojcën 5 të DST
- program për testimin e gjeneratorit dhe motorit diesel (performanc test) pas montimit të modulit.

Keto dy programe, do të provohen për funksionalitetin e tyre ditën e hapjes së tenderit, jo më vonë se ora 10.30 (ora e hapjes së tenderit), nga përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor dhe Operatori/et ekonomike pjesëmarrës në gare. **Disponueshmeria** dhe **Testimi** funksionimit të tyre, është kriter vlerësimi/kualifikimi për operatorët ekonomike, pjesëmarrës në gare.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), nenit 43 pika 1,2,3,4,6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se ata kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Argumentimi i AK : Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën dhe për të vërtetuar aftësitë tekniko-profesionale të OE me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës.

Kërkesat e vecanta të pikës 2.3.2 dhe 2.3.3

- *Argumentimi:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41 pika 4/çtë VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë kapacitetet teknike dhe profesionale për ta perfunduar këtë shërbim.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose

produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimi i Materialeve:

Karakteristikat teknike te gjeneratorit

Gjeneratori diezel i emergjences ka keto te dhena:

Furnitori: “Filippini Gruppi Elettrogeni S.p.a”.

Code: F0500DWMR992

Viti: 2009

RPM : 1500

Moduli i kontrollit te gjeneratorit diezel te emergjences : Gensys REF A40Z0-G-L001

S/N; 2808A020

(DSF TECHNOLOGY GENSYS A40Z0-F-L0001 GENERATOR MANAGEMENT MODULE)

Ndersa dy pjeset kryesore te tije motori diezel dhe gjeneratori elektrik kane keto te dhena teknike:

a. Motori diezel:

- Model: **DEUTZ**
- tipi: **BF8m1015CP**
- turbo intercooler, 1500 rpm
- numri i cilindrave : 8V, cilindrata totale 15.874 lt
- forced lubrication
- skeda elektronike e dyfishte (centralino)
 - Motornr 09174737
 - Engine code D2OC490

b. gjeneratori elektrik

- tipi: Filippini
- fuqia niminale 408 kW
- tensioni nominal 400 V $\pm 5\%$
- frekuenza 50Hz

SPECIFIKIMET TEKNIKE PER “PJESE NDERRIMI PER GJENERATORIN E EMERGJENCES”

Artikulli nr 1 : FV- Moduli i kontrollit dhe komandimit te gjeneratorit i programuar

Moduli GENSYS (qe kerkohet te zevendesohet) është një njësi kontrolli paralele me PLC të integruar , e programueshme e krijuar për panelet elektrike të gjeneratorëve.

Kjo njësi kombinon të gjitha funksionet e nevojshme si me poshte :

- Difekti i rrjetit me tre faza
- Start / Stop (automatik dhe manual) i motorit dhe mbrojtjet
- Kontrolli dhe mbrojtja e alternatorit
- Shfaqja e parametrave mekanikë
- Shfaqja e parametrave elektrike
- Sinkronizimi i Gensetit
- Ndarja e ngarkesës dhe kontrolli i kW
- Ndarja e ngarkesës dhe kontrolli kVAR
- Porta Komunikimesh J1939

Te dhenat e Modulit te difektuar qe do te zevendesohet:



- **Tipi** : Modul menaxhimi gjeneratori
- **Modeli** : GENSYS A40Z0-F-L0001
- **Tensioni** : 12....24 VDC
- **S/N** : 2808A020




Foto e pasme e modulit te difektuar

Moduli i kerkuar, (qe do te zevendesoje te difektuarin), duhet të programohet dhe te konfigurohet nëpërmjet një kompjuteri me softuerin perkates te tij sipas nevojave te gjeneratorit.(ne perputhje me skemen teknologjike te tij . Manuali do ti vihet ne dispozicion OE ne momentin e lidhjes se kontrates).

Nuk ka rendesi marka dhe tipi i prodhuesit, mund te jete edhe nje modul ekuivalent /analog. E rendesishme qe moduli qe do ta zevendesoje te difektuarin, te kete karakteristika teknike te njejta me te, perfshire dhe permasat e montimit.

Pasi te kryhet instalimi dhe programimi i modulit nga operatori ekonomik, ai do te programohet dhe testohen te gjitha funksionet e tij (automatik, manual si dhe celesat e zbarave). Me pas, operatori ekonomik do te kryjeje nje kontroll te pergjithshem te gjeneratorit te emergjences “performanc test” dhe do te beje nje raport teknik per sherbimet e kryera dhe gjendjen perfundimtare te gjeneratorit diesel te emergjences

Ne perfundim te kontrollit te pergjithshem te gjeneratorit te emergjences nga Operatori ekonomik, do te kete nje periudhe testimi 1(nje) mujore per funksionimin e modulit tek gjeneratori. Ky testim do te kryhet nga grupi i punes i TEC Vlore

Artikulli nr 2 : Filtri i vajit lubrifikues



Per reference te dhenat teknike te pjeses qe do te zevendesohet sipas manualit te prodhuesit.

Pjesa qe do te zevendesohet ka keto te dhena : kodi teknik **01174420**
ose ekuivalent

(D-Ømax/min 108mm;H-265.1mm;lidhja d-M16)

Foto per ilustrim

Artikulli nr 3 : Filtri i lendes djegese

Per reference te dhenat teknike te pjeses qe do te zevendesohet sipas manualit te prodhuesit.



Pjesa qe do te zevendesohet ka keto te dhena : kodi teknik.....**0118**
1245ose ekuivalent

(D-Ømax/min 93mm;H-143mm;lidhja d-M16x1.5)

Foto per ilustrim


Artikulli nr 4 : Parafiltri i lendes djegese

Per reference te dhenat teknike te pjeses qe do te zevendesohet sipas manualit te prodhuesit.
Pjesa qe do te zevendesohet ka keto te dhena : kodi teknik **04.014.11352** ose ekuivalent



Pamje per ilustrim

Artikulli nr 5 :Element filtri ajri primar.



Per reference te dhenat teknike te pjeses qe do te zevendesohet sipas manualit te prodhuesit.

Pjesa qe do te zevendesohet ka keto te dhena : kodi teknik...**C 24 650/1 ose ekuivalent**

(A-Ø243mm;B-Ø132mm;C-Ø10.5mm;

H-498mm)

Foto per ilustrim

Artikulli nr 6 :Element filtri ajri sekondar



Per reference te dhenat teknike te pjeses qe do te zevendesohet sipas manualit te prodhuesit.

Pjesa qe do te zevendesohet ka keto te dhena : kodi teknik...**CF 1300ose ekuivalent**

(A-Ø141mm;B-Ø125mm;C-Ø17mm;D-Ø128mm;

H-479mm)

Foto per ilustrim

Artikulli nr 7 : Vaj motori sintetik 10W-40

Per reference te dhenat teknike te vajit qe rekomandohet sipas manualit te prodhuesit.



- a. Deutz oil TLX 10W40 Fe **ose ekuivalent**
- b. Shell oil Rimula 10W40**ose ekivalent**

Foto per ilustrim

Nuk ka rendesi marka e vajit , por duhet te jete vaji “full sintetik ultra hight performance” me viskozitet..... **SAE 10W40** (i pershtatshem per tipin e motorit diezel qe disponojme).

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shenim i rendesishem

Fotot e paraqitura per cdo artikull, jane fotot e modulit dhe te pjeseve te kerkuara, objekt prokurimi. Nuk ka rendesi marka, pamja vizive dhe tipi i prodhuesit. Kudo ku ka nje marke apo emer te caktuar, eshte edhe termi Ekivalent. Meqenese artikujt e listes me siper jane pjese nderrimi, ato duhet te kete karakteristika teknike te njejta perfshire edhe permasat e montimit. E rendesishme qe ato duhet te funksionojne normalisht pa shkaktuar asnje anomali ne gjenerator.

Specifikimet teknike jane hartuar nga specialistet e Autoritetit Kontraktor sh.a, bazuar në nenin 44 pika 5 te VKM.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, sipas nevojave per keto pajisje dhe per kete shërbim furnizim-vendosje te parashikuar dhe miratuar ne programin ekonomik 2024te Termocentralit-Vlore sh.a.